



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 24
23.06.2017

NR. VENDIMI 21
10.07.2017

VENDIM
“Në emër të Republikës”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e përbërë prej:

Luan HASNEZIRI – Kryesues

asistuar nga sekretare **Lavdie HYSAJ**, në Tiranë, sot me datë 10.7.2017, mori në shqyrtim çështjen penale me palë:

KËRKUES: 1. O.N, i datëlindjes XXXXX, lindur në XXXXX, Dibër dhe banues në adresën Rr. “XXXX”, Pall., Nr. X, apartamenti Nr. X, Tiranë, me shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore, i padënuar më parë, i përfaqësuar në gjykim nga avokat A.K, në bazë të prokurës së posaçme me Nr. 1606 Rep, Nr. 688 Kol, datë 4.7.2017.

2. G.N, i datëlindjes XXXXX, lindur në Levan, Fier dhe banues në adresën Rr. “XXXX”, Pall., Nr. X, apartamenti Nr. X Tiranë, me shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore, i padënuar më parë, i përfaqësuar në gjykim nga avokat A.K, në bazë të prokurës së posaçme me Nr. 1606 Rep, Nr. 688 Kol, datë 4.7.2017.

PERSON I TRETË: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, e përfaqësuar në gjykim nga prokurore Dolereza Musabelliu.

OBJEKTI: Heqjen e masës së sekuestros mbi pasurinë Godinë banimi, me lokale shërbimi+garazh, X-X X-XX/X, e emërtuar Hotel “XXXXX”, së bashku me të gjitha sendet e luajtshme arreduese që ndodhen brenda hotelit, ndodhur në adresë: Lagja nr.X, rruga XXXX, godina nr. X, Sarandë, në emër të shtetasve O.N dhe G.N.

BAZA LIGJORE: Neni 12 i ligjit nr.1092 datë 10192 datë 03.12.2019 “Për ndalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, para hyrjes në fuqi të ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 70, të vitit 2017.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen, administroi provat, dëgjëoi në diskutimin përfundimtar

përfaqësuesin e posaçëm të kërkuesve, i cili, kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit, pasi dëgjoi prokuroren, e cila, ishte dakort që të pranohet kërkesa e kërkuesve;

VËREN:

1. Me vendimin nr. 27, datë 5.12.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, është vendosur pranimi i kërkesës së Prokurorisë për Krime të Rënda, Tiranë, duke vendosur masën e sekuestros mbi pasurinë Godinë banimi, me lokale shërbimi+garazh, X-X X-XX/X, e emërtuar Hotel “XXXXXX”, së bashku me të gjitha sendet e luajtshme arredeuse që ndodhen brenda hotelit, ndodhur në adresë: Lagja nr.X, rruga XXXX, godina nr. X, Sarandë, në emër të shtetasve O.N dhe G.N, në bazë të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, të ndryshuar.

2. Me marrjen e këtij vendimi nga ana e gjykatës, nga ana e Prokurorisë për Krime të Rënda, pasi janë kryer veprimet që ajo ka çmuar të nevojshme për hetimin pasuror, me datë 16.6.2017 është vendosur pushimi i procedimit pasuror, me arsyetimin që, nuk plotësohen të gjitha kushtet e parashikuara nga ligji Nr. 10 192, datë 3.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, duke përdorur si bazë ligjore nenin 24, pika 2 e këtij ligji.

3. Pas marrjes së këtij vendimi nga ana e prokurorisë, kërkuesit O.N dhe G.N, me datë 23.6.2017, me anë të përfaqësuesit të tyre, më prokurë të posaçme, kanë paraqitur kërkesë para gjykatës, me objekt heqjen e sekuestros mbi pasurinë Godinë banimi, me lokale shërbimi+garazh, X-X X-XX/X, e emërtuar Hotel “XXXXXX”, së bashku me të gjitha sendet e luajtshme arredeuse që ndodhen brenda hotelit, ndodhur në adresë: Lagja nr.X, rruga XXXX, godina nr. X, Sarandë, kërkesë për të cilën përfaqësuesi i prokurorisë u shpreh që ishte dakort që ajo të pranohej.

4. Në kërkesën e paraqitur nga ana e tyre dhe të depozituar në gjykatë, me datë 10.7.2017, kërkuesit kanë vendosur si bazë ligjore për revokimin e vendimit nr. 27, datë 5.12.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, me të cilin ishte vendosur masa e sivekuestros mbi këtë pasuri, në bazë të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, të ndryshuar, nenet 274 dhe 275 të Kodit të Procedurës Penale, ndërsa, gjatë gjykimit dhe në diskutimin përfundimtar, bënë ndryshimin e bazës ligjore të tyre, duke kërkuar shuarjen e masës së sekuestros, duke përdorur si bazë ligjore, pikën 4 të nenit 12 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 70, të vitit 2017.

5. Për ndryshimin e bazës ligjore të bërë nga kërkuesit, gjatë gjykimit të kësaj çështjeje, përfaqësuesja e organit të akuzës u shpreh që ishte dakort me këtë ndryshim, duke kërkuar edhe ajo shuarjen e masës së sekuestros të vendosur, me vendimin nr. 27, datë 5.12.2017, të kësaj gjykate, mbi këtë bazë ligjore, arsye për të cilën, ajo, po ashtu u shpreh që, nuk e çmonte të arsyeshme që të paraqiste para kësaj gjykate, provat ku ishte bazuar për dhënien e vendimit për pushimit e procedimit pasuror në ngarkim të shtetasve O.N dhe G.N.

6. Përsa i përket zgjidhjes në themel të kërkesës së paraqitur nga kërkuesit, gjykata e çmon me vend të shprehet, fillimisht që, baza ligjore ku, kërkuesit e kanë bazuar kërkesën, si ajo e vendosur në kërkesën me shkrim dhe të depozituar në gjykatë, ashtu edhe ajo që u ndryshua gjatë gjykimit, është e gabuar dhe e pabazuar dhe për këtë arsye, gjykata nuk do ta bazojë

vendimin e saj, në bazën ligjore të pretenduar nga kërkuesi.

7. Për bazën ligjore që kërkuesit kanë vendosur në kërkesën me shkrim dhe të depozituar në gjykatë, në datë 23.6.2017 dhe, që është sipas kërkuesve, neni 274 dhe 275 i Kodit të Procedurës Penale, është e qartë që kjo bazë ligjore është, haptazi e pasaktë dhe e pabazuar, sepse, vendosja e masës së sekuestrës ndaj pasurisë së kërkuesve, nga ana e kësaj gjykate, është bërë në bazë të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, të ndryshuar dhe jo në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale dhe, për këtë arsye, edhe heqja e masës së sekuestrës për këtë pasuri, nga kërkuesit, duhet të ishte bazuar në ligjin e mësipërm dhe jo në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

8. Po ashtu, edhe ndryshimi i bazës ligjore nga kërkuesit, gjatë gjykimit, duke e bazuar kërkesën e tyre në pikën 4 të nenit 12 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 70, të vitit 2017, çmohet nga gjykata si e pabazuar, sepse, në pikën 1 të Dispozitës kalimtare, parashikohet që, ndryshimet e bëra me ligjin nr. 70, të vitit 2017, zbatohen për kërkesat e marrjes së masave parandaluese të paraqitura nga prokurori në gjykatën kompetente, pas hyrjes në fuqi të tij.

9. Duke iu referuar faktit që ndryshimet e ligjit ligjin nr. 70, të vitit 2017, kanë hyrë në fuqi me datë 23.6.2017, ndërkohë që, kërkesa nga ana e prokurorit për marrjen e masës parandaluese ndaj kërkuesve që, në rastin konkret ka qenë masa e sekuestrimit të pasurisë, është paraqitur nga prokurori, me datë 2.12.2016, pra, para hyrjes në fuqi të ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 70, të vitit 2017, në ligjin e posaçëm, nr. 10192, datë 03.12.2009, pika 4 e nenit 12 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 70, të vitit 2017, nuk mund të gjejë zbatim në këtë rast.

10. Nisur sa u arsyetua më lart, gjykata nuk do ta zgjidhë çështjen, duke iu referuar bazës ligjore të pretenduar nga kërkuesi, as asaj të paraqitur në kërkesën me shkrim dhe as asaj të ndryshuar gjatë gjykimit, por në zbatim të parimit sipas të cilit, gjykata prezumohet që e njëj ligjin “*iura novit curia*”, gjykata çmon se, baza ligjore që duhet të zbatohet, për zgjidhjen e çështjes konkrete është, neni 12 i ligjit ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, të ndryshuar, para ndryshimeve të bëra këtij ligji me ligjin nr. 70, të vitit 2017.

11. Bazuar në përmbajtjen e nenit 12 i ligjit ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, si dhe në frymën e të gjithë këtij ligji, para ndryshimeve të bëra këtij ligji me ligjin nr. 70, të vitit 2017, rezulton që, gjykata nuk ka rol aktiv, por ka rolin e arbitrit të paanshëm, duke ia besuar organit të akuzës mbrojtjen e interesit publik, në kushtet kur, ky i fundit, për shkaqet që ka çmuar të arsyeshme, ka vendosur pushimin e procedimit pasuror, në ngarkim të kërkuesve, me arsyetimin se, nuk përmbushen kërkesat e ligjit të veçnatë nr. 10192, datë 03.12.2009, për konfiskimin e pasurisë së tyre, gjykata, nuk mund të vlerësojë këtë vendimmarrje të akuzës dhe është e detyruar që, të pranohet kërkesën e kërkuesve për heqjen e masës së sekuestros, pasi, me marrjen e vendimit të pushimit të procedimit pasuror nga organi i akuzës, mungon objekti dhe shkaku ligjor se pse, kjo pasuri të qëndrojë e sekuestruar.

12. Përderisa, organi që ligji i ka besuar mbrojtjen e interesit publik, që është në këtë rast, organi i akuzës, ka vlerësuar dhe vendosur që, këto pasuri nuk mund të konfiskohen dhe në kushtet kur, ligji që ishte në fuqi kur është kërkuar kjo masë parandaluese, si dhe kur është marrë vendimi për pushimin e procedimit pasuror, nuk i jep të drejtë gjykatës për të vlerësuar këtë vendimmarrje të organit të akuzës, sepse, kjo ka qenë zgjedhje e vetë ligjit, e cila, është ndryshuar më vonë, me ndryshimet e bëra në ligj, me ligjin nr. 70, të vitit 2017, gjykata, në këtë rast, është e detyruar që të disponojë me pranimin e kërkesës së kërkuesve, vendim, i cili, ka, thjesht karakter formal dhe jo karakter substancial ose të zgjidhjes së çështjes në

meritë apo thelb.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, para ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 70, të vitit 2017.

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuesve O.N dhe G.N.
2. Heqjen e masës së sekuestros mbi pasurinë Godinë banimi, me lokale shërbimi+garazh, X-X X-XX/X, e emërtuar Hotel “XXXXX”, së bashku me të gjitha sendet e luajtshme arreduese që ndodhen brenda hotelit, ndodhur në adresë: Lagja nr.X, rruga XXXX, godina nr.X, Sarandë, në emër të shtetasve O.N dhe G.N.
3. Ngarkohet Agjensia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave, Tiranë, si dhe Zyra e përkatëse e Përmbarimit, për ekzekutimin e këtij vendimi.
4. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, Tiranë, brenda afatit ligjor.
5. U shpall, në Tiranë, sot me datë 10.7.2017.

**SEKRETARE
LAVDIE HYSAJ**

**GJYQTAR
LUAN HASNEZIRI**

